



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA POGRADEC**  
KOMISIONI

Nr \_\_\_\_\_ .Prot

Pogradec, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2019

**FTESE PËR PJESËMARRJE**

**Emri dhe adresa e bashkisë Pogradec:**

Emri: Bashkia Pogradec  
Adresa: Lagja Nr .2, Bulevardi “Rreshit Çollaku”.  
Tel/Fax: 083222222  
E-mail: [bashkiapogradec@gmail.com](mailto:bashkiapogradec@gmail.com)

Bashkia Pogradec, do të zhvillojë **aktivitetin artistiko - kulturor "Celja e sezonit turistik 2019"**, me fond 10 000 (Dhjetë mijë) Euro me Tvsh, vënë në dispozicion nga "Bashkimi European".

Afati perfundimtar per paraqitjen dhe dorezimin e ofertes Tuaj, do të jetë **diten e Hene, datë 10.06.2019, ora 16:00.**

**Dorëzimi i ofertes te behet ne, adresa e emailit te bashkise Pogradec.**

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt me këto të dhënat të shërbimit si më poshtë :

Nr	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Cmimi	vlera/Euro
<b>1</b>	<b>Advertising</b>				
	(Reklama, Tv,)	sherbim 24 ore		1	
	Banera, Poster, Fletpalosje,Album fotografik	cope		50	
	Aksesore promovues	cope		5	
	<b>SHUMA I</b>				
<b>2</b>	<b>Ftesa</b>	cope		350	
	<b>SHUMA II</b>				

<b>3</b>	<b>Aktivite kreative</b>				
	Personazhe animatore	Persona	10		
	Aksesore zbukurues	cope	100		
	Aktivitet zbavites per femije	sherbim	1		
	Pajisje mbeshtetese	cope	10		
	SHUMA III				
<b>4</b>	<b>Prezantime, Pritje, Sherbime mbeshtetese</b>				
	Coffee Break	sherbim	1		
	Prezantues, Skenograf, regjizor, fotograf, Dj, staf mbeshtetes	sherbim	10		
	Pajisje mbeshtetese	cope	5		
	SHUMA IV				
<b>5</b>	<b>Shpenzime per artiste, sportiste</b>				
	Artist, Xhonglere, Sportiste, Kengetare etj	sherbim	15		
	SHUMA V				
<b>6</b>	<b>Aktivitet Kulinar</b>				
	Ushqime tradicionale pogradecare( pajisje, Ushqime etj)	Sherbim	1		
	SHUMA VI				
	TOTALI ME TVSH (SHUMA I - SHUMA VI)				<b>10,000</b>

## KREU II SPECIFIKIME TEKNIKE

**(REKLAMA, TV):**

Nr	EMERTIMI	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1.	<b>Filmim + Transmetim TV, "Per cdo eviniment te Bashkise Pogradec"</b>	<b>Minuta</b>	<b>90</b>		
2	<b>Filmim + Transmetimin emisioni</b>	<b>Minuta</b>	<b>180</b>		

Subjekti duhet qe te ofroje sherbimin e tij, ne territorin e qytetit te Pogradecit dhe ne 7 Njesite Administrative te Bashkise Pogradec, sipas parametrave teknik, si me poshte vijon:

- Sherbim transmetim i panderprere per 24 ore.
- Problemet teknike te zgjidhen brenda 1 dite nga momenti i njoftimit te fituesit.

- Sherbimi duhet te kete garanci perqindje vlefshmerie 90%.

- Sherbimi duhet te plotesoje kerkesat themelore te komformitetit sipas standarteve teknike, ne drejtim te cilesise dhe parametrave teknik.

**Kontraktori duhet t'i kryejë dhe përmbushë detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të përcaktuara në aktet ligjore, nënligjore, ne perputhje me parimet dhe karakteristikat teknike dhe specifike të sherbimit objekt kontrate.**

### **SPECIFIKIME FLETEPALOSJE + BANERA+ AKSESORE PROMOVUES**

**Fletepalosje:** Kompozim, Dizenjim, Printim fletepalosje 20 cm x 21 cm, 170 gr, me nje palosje, me 4 ngjyra + panton.

**Banera:** Banera me strukture, (3m x 2m) . Kompozim, Dizenjim, Printim dhe vendosje e banerit ne vendet e percaktuara nga Bashkia Pogradec.

**Aksesore promovues:** Kapele me strehe me logim

Bluza T-shirt me logim

Byzylyk dore me logim

Shaje me logim

- Prodhimi i 50 (pesëdhjet) copë T-shirt.
- T-Shirt material pambuk me mëngë të shkurtra.
- Ngjyra e bardhë.
- Stampuar logo zyrtare e bashkise Pogradec me ngjyrë blu.

### **SPECIFIKIME Aktivitet Kulinar**

Nr.	EMERTIMI	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlefte
1	Pjata e pare personale, fileto pule me pana kerpudhe	cope	350		
2	Pjata e dyte personale, peshk koran me garniture	cope	350		
3	Embëlsire personale	cope	350		
4	Mesore 1 per 5 persona (Miks djathrash, fruta, rukula me gorgonxola dhe sheqe)	cope	40		

Ambjenti duhet te kete nje siperfaqe jo me te vogel se 200 m<sup>2</sup>

Ambjenti duhet te jete i prenotuar vetem per aktivitetin e Bashkise Pogradec dhe te mos kete nderthurje me aktivitete te tjera te ngjashme.

Ambjenti ku do te realizohet aktiviteti te jete brenda qytetit te Pogradecit.

Operatori Ekonomik te perfshije dhe transportin e pjesemaresve ne cmimin e mesiperem.

Kushtet e ambientit të restorantit :

- Foni jo më pak se 16000 Watt, mixer 6 kanale, mikrofonta, wireless 4 copë.
- Personeli që do të shërbejë të jetë nga 15 deri 20 punonjës .
- Të ketë ajër të kondicionuar dhe aspirim.
- Të ketë parkim jo më pak se 100 vende dhe të siguruar me roje.
- Subjekti duhet të ketë shërbim të sigurt të hotelit 24/7 ( kamera dhe personel sigurimi)
- Ambjenti duhet të ketë dalje emergjence sipas kushteve të sigurimit teknik.
- Ambjenti duhet të ketë dalje në verande

Data e ofrimit të shërbimit është data 14.06.2019.

### **SPECIFIKIME Coffee Break**

<i>I</i>	Pije	cope	350		
----------	------	------	-----	--	--

**Pije:**

- Lëngje frutash
- Verë e kuqe/bardhë
- Birra të ndryshme
- Kafe (Turke, makiato, espres)

### **SPECIFIKIME**

**Shpenzime për artiste, sportiste  
Prezantime, Pritje, Shërbime mbështetëse**

#### **Hapësira e dedikuar për eventin.**

- Sipërfaqja ku do të organizohet aktiviteti do të jetë në varësi të përmasave dhe karakteristikave vizuale të çdo sheshi.
- Sipërfaqja ku do të organizohet aktiviteti është e saktësuar në programin e këtij aktiviteti.

#### **Skena (Stage) për performancë artistike, këngëtarët dhe folësit.**

- Përmasat e stage-it do të jenë 15 metra gjatësi dhe 4 metra gjerësi.
- Dyshemeja e stage-it do të jetë e mbuluar nga një tapet ngjyrë blu, me përmasat 15x4m.
- Në qendër të stage-it do të jetë i vendosur një mikrofon static.
- Sigurimi i gjithë paisjeve elektrike dhe elektronike për realizimin e performancave artistike dhe përshëndetjeve të rastit.

Performanca të grupeve të ndryshme muzikore, kërcimtarë, animatorë, hapësira argëtimi për fëmijë, duke e kthyer qendrën e qytetit në një vend të vertetë argëtimi.

- 1 (një) DJ profesionist, i cili do të performoj në një program me muzik të zgjedhur, kohëzgjatja e të cilit të variojë 3 (tre) deri në 4 (katër) orë.

- 4 (Kater) kengetare profesioniste, të cilet do të performojne në një program me muzik të zgjedhur, kohëzgjatja e të cilit te variojë 3 (tre) deri në 4 (katër) orë.
- 3 (Tre) xhonglere.
- 3 (Tre) kercimtare.
- 1 (Nje) moderator.

## **SPECIFIKIME PAJISJE MBESHTETSE**

### **Ndriçimi**

- Ndricimi i ambientit duhet të jetë i përshtatshëm me orarin kur do të zhvillohet aktiviteti.
- Do të krijohet një sfond ndriçimi për hapësirën e dedikuar artistëve dhe DJ-it që do tëperformojë.

### **Ekрани Led**

- Përmasat e ekranit led do të jenë 10 metra gjatësi , 5 metra lartësi.

Ekрани led do të vendoset në qendër të stage-it dhe do të shfaqë një dokumentar me karakter institucional ku të promovohet historia e Postës Shqiptare që nga fillimet dhe deri më sot, kapacitetet njerëzore dhe infrastrukture të saj. Po ashtu në ekran do të shfaqen spote publicitare dhe promovhen produktet dhe shërbimet kryesore që ofron bashkia Pogradec.

## **KREU III**

### **KRITERET PER TU SHPALLUR FITUES:**

Operatori ekonomik ose agjencia do te shpallet fitues bazuar në:

1. Përvojës në organizimin e ngjarjeve.
2. Çmimit me te ulet të ofruar nga operatorët e specializuar

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor (në rastet kur kërkohet), dokumentet si më poshtë:

1. Kopje të ekstraktit të QKB-së, i lëshuar jo më vonë se tre muaj nga dita e tenderit.
2. Vërtetim banke ku të jetë e përcaktuar numri i llogarisë dhe kodi IBAN për efekt të kryerjes së pagesës. Në rast se shpallet fitues.
3. Formularin e cmimit të ofertës së specifikuar. me njësi, sasi, çmim dhe vlerë.

\*Mosparaqitja e njërit nga dokumentat e lartë përmendur përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik.

Vleresimi i ofertave do te behet ne prani te anetareve te komisionit me date **10.06.2019, ora 16:00.**

Afati i shërbimit do te jete, nga e nesermja e nenshkrimit te kontrates.

## **KOMISIONI:**